

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË AGJENCINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORË

Raporti Përfundimtar "Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare", për periudhën e aktivitetit janar 2011 deri më 31.06.2013, kryer në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Qarku Vlorë me objekt: "*Mbi veprimtarinë për monitorimin dhe mbrojtjen e mjedisit; auditim mbi zbatimin e procedurave të vlerësimit të ndikimit në mjedis si dhe dhënien e mendimit për pajisjen e subjektit me leje mjedisore; zbatimi i procedurave për pajisjen e subjektit me autorizim dhe pëlqim mjedisor; zbatimi i procedurave të vetëmonitorimit dhe monitorimit të mjedisit nga ndotja dhe dëmtimi; auditimi i dosjeve mjedisore që administrohen nga njësia e Inspektoratit të Mjedisit; auditimi i ushtruar nga ARM, në subjektet që me aktivitetin e tyre kanë ndikim të lartë e të mesëm në mjedis; zbatimi i marrëveshjeve midis inspektoratit të mjedisit me organet e tjera të kontrollit, për kryerjen e inspektimeve e kontrolleve të përbashkëta; aplikimi i sanksioneve të vendosura nga Inspektorati Mjedisor, si dhe arkëtimi i gjobave, etj.*", është miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 172 datë 30.12.2013.

Bazuar në nenin 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 706/6 prot., datë 30.12.2013 dërguar z. Kujtim Sulçe, Kryetar i ARM Qarku Vlorë dhe shkresën nr. 706/7 prot., datë 30.12.2013, dërguar z. Lefter Koka, Ministër i Mjedisit, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave organizative dhe disiplinore.

Si masa organizative, midis të tjerave është rekomanduar dhe kërkuar që:

- ARM të përgatisë planet mujore dhe vjetore të punës; me hapat proceduralë që do të ndjekë gjatë monitorimit të subjektit që aplikon për një nga lejet mjedisore.
- ARM në procesin e pajisjes me autorizim dhe pëlqim mjedisor të specifikojë me hollësi sipas tipit të projektit kushtet e ndërtimit dhe funksionimit të veprimtarisë së lejuar, mënyrën e administrimit mjedisor të mbetjeve, sidomos atyre të rrezikshme.
- ARM në pëlqimin dhe autorizimin mjedisor të përcaktojë në mënyrë të hollësishme masat që do të marrë subjekti për minimizimin e ndikimeve negative në mjedis gjatë fazës së ndërtimit dhe zhvillimit.
- ARM, në mendimet e dhëna për lejet mjedisore, bazuar në raportin teknik dhe në Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, të pasqyrojë me përgjegjësi e në mënyrë konkrete sasinë e çlirimeve dhe daljes në mjedis të lëndëve të gazta, të ngurta e të lëngëta, të vibracioneve e zhurmave për çdo subjekt sipas natyrës së aktivitetit që do të zhvillojë si dhe të shprehet nëse projekti i propozuar është në përputhje me legjislacionin në përgjithësi dhe atë mjedisor në veçanti.
- Në rastet ku subjektet zhvillojnë aktivitet të parregullt, pa u pajisur me dokument mjedisor më parë dhe për këtë janë lënë detyra apo afate nga ana e inspektorëve, menjëherë të merren masa për aplikimin e sanksioneve administrativo ligjore.
- Njësia e Inspektimit e ARM Vlorë të krijojë për çdo subjekt me ndikim në mjedis dhe të pajisur me një nga lejet mjedisore dosjen e përditësuar, e cila të ruhet e administrohet nga Njësia e Inspektoratit të Mjedisit në formë elektronike ose shkresore.
- Të kontabilizohen gjobat e vendosura, si dhe të veprohet më shpejt për dërgimin e vendimeve të gjobave në Gjykatë për të nxjerrë titujt ekzekutivë dhe dërgimin në Zyrën e Përmbartimit për ekzekutimin e 105 sanksioneve (gjoba) ndaj subjekteve që paraqiten me shkelje në zbatimin e legjislacionit mjedisor me vlerë gjithsej 43 milion lekë.

- Për rastet e kundravajtjeve administrative ku ligji parashikon ndëshkim administrativ të subjekteve, vënia e masës së pezullimit të aktivitetit ose heqjes së lejes duhet të merret si masë shoqëruese përkrah masës së ndëshkimit administrativ.
- Të merret masa administrative “gjobë” për subjektet e pajisura me leje mjedisore të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre në qarkun e Vlorës, për mos dërgimin e të dhënave për gjendjen e mjedisit në afatet e përcaktuara.
- Inspektorët e mjedisit të hartojnë regjistrin e të dhënave për të gjitha subjektet e kontrolluara të shoqëruara me detyrat përkatëse, afatet e përmbushjes së detyrave dhe përvijueshmërinë e ndjekjes së këtyre detyrave etj.

Referuar parregullsive dhe shkeljeve të ndryshme të konstatuara gjatë ushtrimit të detyrës, **i është kërkuar Ministrisë së Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave vlerësimi i shkeljeve të konstatuara**, duke rekomanduar marrjen e masave disiplinore si më poshtë:

- “Vërejtje me paralajmërim për pushim nga detyra” për punonjësin [REDAKTUAR], me detyrë Koordinator i Njësisë Teknike dhe Specialist i Mbetjeve Urbane, pasi: nuk ka çelur regjistrin e subjekteve që kanë aktivitet me ndikim në mjedis; në dhënien e mendimit që i është përcjellë ministrisë për t’u pajisur subjekti me leje mjedisore si dhe në autorizimet dhe pëlqimet mjedisore nuk janë përcaktuar kushtet dhe rrethanat e shprehura konkretisht për çdo subjekt sipas natyrës së projektit dhe aktivitetit të propozuar; në pëlqimet dhe autorizimet mjedisore nga ana e ARM nuk është bërë një analizë e hollësishme raporteve të VNM-së, të paraqitur nga subjektet dhe nuk janë plotësuar shtojcat përkatëse; ka vepruar në mënyrë të ngadaltë në lidhje me dërgimin e vendimeve të gjobave në Gjykatë për të nxjerrë titujt ekzekutivë dhe dërgimin në Zyrën e Përmbartimit për ekzekutim; nga konstatimi i shkeljeve në terren ka prodhuar akte administrative absolutisht të pavlefshme duke përdorur referenca ligjore të gabuara etj.
- Gjithashtu kjo masë disiplinore është dhënë për punonjësin [REDAKTUAR] me detyrë Inspektor pranë ARM Qarku Vlorë, në cilësinë e Koordinatorit të Njësisë së Inspektimit për periudhën 11.11.2008 – 24.09.2012 dhe për punonjësin [REDAKTUAR], me detyrë Koordinator i Njësisë së Inspektimit për periudhën 24.09.2012 – 30.06.2013, pasi nuk ka krijuar dosjen mjedisore të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në qarkun e Vlorës; ka vepruar në mënyrë të ngadaltë në lidhje me dërgimin e vendimeve të gjobave në Gjykatë për të nxjerrë titujt ekzekutivë dhe dërgimin në Zyrën e Përmbartimit për ekzekutim; nga konstatimi i shkeljeve në terren ka prodhuar akte administrative absolutisht të pavlefshme sepse ka përdorur referenca ligjore të gabuara etj.
- “Vërejtje me shkrim” për dhjetë punonjësit [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], me detyrë Inspektorë Mjedisori, pasi nga konstatimi i shkeljeve në terren kanë prodhuar akte administrative absolutisht të pavlefshme, duke përdorur referenca ligjore të gabuara si ligji nr. 9890, datë 20.03.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8934, datë 05.09.2002, neni 2, pika 2/ç; për subjektet që kanë ushtruar aktivitet pa leje mjedisore të veprimtarive që ndotin e dëmtojnë mjedisin, klasifikuar shkelje sipas ligjit nr. 8934, datë 05.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, neni 82 pika 2/g, kanë vendosur masën e pezullimit të aktivitetit, ndërkohë që krahas masës së pezullimit që është masë plotësuese, duhet të kishin aplikuar dënim administrativ, bazuar në ligjin nr. 9983, datë 08.09.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8934, datë 05.09.2002, neni 83 pika 1/ç, ku parashikohet gjobë nga 1.000.000 deri më 2.000.000 lekë etj.

Të tjera: Gjatë trajtimit të çështjeve në Raportin e auditimit janë konstatuar përgjegjësi të natyrës drejtuese dhe menaxhuese për z. [REDAKTUAR], në cilësinë e Kryetarit të Agjencisë Rajonale të Mjedisit Qarku Vlorë, të cilat mund të vlerësoheshin me masën disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për pushim nga detyra”. Nuk është rekomanduar masë disiplinore për personin e sipërpërmendur duke e konsideruar të ezauruar, pasi nuk është në marrëdhënie pune me këtë subjekt. Ngarkohet Ministria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave të njoftojë Departamentin e Administratës Publike për rezultatet e auditimit të KLSH për këtë person.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Investimeve e Projekteve me Financime të Huaja, Shoqërive Publike dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

Shënim: Auditimi u krye nga z.Nefail Xhëpexhiu përgjegjës i grupit, z. Neritan Matoshi, dhe zj. Keida Muça. Më tej u shqyrtua nga z. Gjovalin Preçi Kryeauditues, Drejtori i Departamentit z. Xhafer Xhoxhaj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë z. Ermal Yzeiraj dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm zj. Helga Vukaj.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT